

AKT THEMELIMI

DHE

STATUTI I SHOQERISE

OLSID-2018 SH.P.K.

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Neni 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i plotë i shoqërisë është :

OLSID-2018 SH.P.K

është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria **OLSID-2018 SH.P.K**, funksionimi i se ciles do te behet ne mbeshtetje te plote me legjislacionin Shqipetar per shoqerite tregetare ne baze te ligjit Nr. 9901 date 14/04/1998.

Neni 2

LLOJI I SHOQËRISË

Shoqëria **OLSID-2018 SH.P.K**

është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.



Neni 3

ADRESA E SELISË

Selia e **OLSID-2018 SH.P.K** është ne fshatin Shushice ,ne pasurine me nr 281/14 ,Zona kadastrale 3446 , njesia administartive Shushice,Bashkia Vlore Shoqëria mund të hap filiala,zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Aktiviteti tregëtar per mbareshtimin dhe shitje e shpendeve per therje.

Neni 5

PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat 20 vjecar dhe mbas mbarimit te ketij afati ne marreveshje me palet ky afat mund te shtyhet.

Neni 6

VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Veprimtaria e Shoqërisë është :

Mbareshtimin ,ritjen dhe tregëtimin e shpendeve per therje.



Neni 7

THEMELUESIT E SHOQËRISË

Themelues jane :

1.**Irena Aliraj** e bija e Agronit, e datelindjes 17/12/1990, me nr ID J06217077K me arsim te mesem lindur ne Lagjen Rexhepaj, fshati Gorisht ,Vlore dhe banuese ne Lagjia 28 Nentori ,Vlore.

2.**Ermis Hoxhaj** i biri i Jetnorit, I datelindje 04/04/1989 ,me nr ID I90404065Q me arsim te larte lindur ne Llakatund dhe banues ne Lagjen "PAVARESIA" rruga Jani Kosta, Vlore.

Neni 8

ADMINISTRATORET

Administratori :

Administrator caktohet z.Ermis Hoxhaj, i diplomuar nga Universitetin Amerikan te Tiranes , lindur ne Llakatund dhe banues ne Lagjen Pavaresia ,Vlore ,per nje afat 1-vjecar.

Neni 9 KAPITALI

9.1 Aksionet e shoqerise perbehen nga Kapitali Themeltar prej 100,000 lekesh i ndarc ne 2 kuota me vlere nominale prej 50,000 lekesh secila, nga te cilat :

1-**Irena Aliraj** zoteron 1 kuote ose 50 % te aksioneve me vlere 50,000 leke.

2-**Ermis Hoxhaj** zoteron 1 kuote ose 50 % te aksioneve me vlere 50,000 leke.

9.2 Kushdo nga aksioneret e mesiperm me pelqimin e ortakut tjetër i cili ka te drejten e parablerjes dhe me vendim te posacem te aksionereve themelues, mund te beje shitjen ose transferimin e kuotave tek persona te tjere brenda familjes ose jashte saj.

9.3 Kushdo nga aksioneret e mesiperm ka te drjete te caktoje nje perfaqesuesin e vet ne te gjitha vendimmarrjet qe kane te bejne me mbarevajtjen e ketij aktiviteti me ane te nje prokure noteriale te posacme.

Neni 10

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E THEMELUESVE

10.1. Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

10.2. Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përeaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

10.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

10.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjeri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirrologarive bankare, blerjen dhe dhënjën me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

10.5. Çdo aksioner ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron.

10.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionerit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 11

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organi drejtues i shoqërisë është :

1. Administratori

Neni 12

E DREJTA E VOTES

12.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe çdo aksion të jep të drejtën e të paktës një(1) vote.



12.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi ,kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 13

NËPUNËSIT E SHOQËRISË

13.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjidhen nga Administratori me pelqimin e te gjithë ortakeve.

13.2.Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Administratorin sipas dispozitave te Ligjit për Shoqërite Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.

Neni 14

Administratori

14.1. Administrator caktohet z.Ermis Hoxhaj per nje afat 1-vjecar, i cili do të ushtroje funksionet e tyre ne baze te legjislacionit ne fuqi.

14.2. Administratori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit ne baze te legjislacionit ne fuqi.

14.3 Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen vecanërisht një faj i rëndë i Administratorit ,paaftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve.

Neni 15

Kompetencat dhe kufizimet

15.1 Administratori ka këto kompetenca:

- Të paraqitet,përfaqësoje dhe nënshkruaje për shoqërinë
- Të udhëheqe afarizmin e shoqërisë,
- Të organizoje dhe udhëheq procesin e punës,
- Të përgatise pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- Të propozoje organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- Të pranoje në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- Të vendosi mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- Të kujdeset për ligjshmerine e punës në shoqëri,
- Të vendosi mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- Të kryenje edhe punë të tjera në harmoni me ligjin dhe statutin.

15.2. Administratori si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidh Kontrata dhe kryejë të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh.

Neni 16

Përfaqësimi

Nga ana ligjore ,Shoqëria përfaqësohet nga Administratori.

Neni 17

NDARJA ,BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet,bashkohet,likuidohet ose transformohet në një formë tjetër,përpara afatit të përcaktuar,me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionerve,në përputhje me parashikimet e “Ligjit për Shoqëritë Tregtare”.

Neni 18

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

18.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

18.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.


18.3. Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Data. 16/04/2018

Vendi: Vlore

Themeluesit :

Irena Aliraj

Irena Aliraj


Ermis Hoxhaj

Ermis Hoxhaj
